

## AKT THEMELIMI

### SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “PEDAGOGU” SHPK

Ortakët themelues si më poshtë:

- Z. Romir Rexha, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 22/06/1983, lindur në Durres, SHQIPERI, banues në Durres, Rruga: Lagjia 2, Rruga: Sefer Efendiu, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal I30622068P
- Z. Dardan Seferaj, shtetas Kosovar, i datëlindjes 13/11/1987, lindur në Glogoc, KOSOVE, banues në, Rruga: Fehmi e Xheve LLadrovci, nr 50, Glogoc, Kosove, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar,mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal 1174349378.

#### *Pjesa e përgjithshme*

Bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”, sot me datë 06/04/2021 hartojnë këtë Akt – Themelimi si më poshtë vijon:

#### NENI 1

##### *Emri*

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “**PEDAGOGU SH.P.K**”. Ndryshimi i emërtimit të shoqërisë mund të bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

#### NENI 2

##### *Forma*

Shoqëria tregtare “**PEDAGOGU SH.P.K**”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

#### NENI 3

##### *Zyra Qëndrore*

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **PEDAGOGU SH.P.K**, do të ketë zyrën e saj qëndrore ne: DURRES Lagjia 2 Rruga : ”Sefer Efendiu”, Pallati “Four Sister”, zone kadastrale 8512, nr.pasurie 22/593/ND-N-20.

3.2 Ndryshimi i zyrës qëndrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

#### NENI 4

##### *Objekti i veprimitarisë*

1

Shoqëria ka si objekt aktiviteti në Shqipëri dhe jashtë:

Kurse te formimit professional, Murature dhe Suvatime.

#### NENI 5

##### *Kohëzgjatja*

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë deri me date 31/Dhjetor/2050 dhe mund të shtyhet sipas ligjeve në fuqi.

#### NENI 6

##### *Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit*

Shoqëria tregtare "PEDAGOGU" SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

#### NENI 7

##### *Përgjegjësia e Ortakëve*

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimin e shoqërisë "PADAGOGU" SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

#### NENI 8

##### *Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat*

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "PADAGOGU" SHPK është 100.000 (njeqind mijë) Leke, ndarë në 2 kuota, e cila është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

Z – ROMIR REXHA, është ortaku i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, pjesëmarrja në përqindje eshte e barabartë me 50% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë kapitali 50.000 (pesedhjete mijë) Leke

Z – DARDAN SEFERAJ, është ortaku i shoqërisë, i cili zotëron 1 kuotë, pjesëmarrja në përqindje eshte e barabartë me 50% të kapitalit të shoqërisë, me vlerë kapitali 50.000 (pesedhjete mijë) Leke

#### NENI 9

##### *Organet e shoqërisë*

9.1 Organet e shoqërisë janë:

- Asambleja e ortakëve
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

9.2 Në rast zmadhimi të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, të gjithë ortakët kanë të drejtë të nënshkruajnë dhe shlyejnë pjesët e kapitalit të zmadhuar në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

#### NENI 10

##### *Administratori*

10.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administratori i shoqërisë është Z. ALBAN DAKOLI, i datëlindjes 21/11/1982, lindur në Durres, SHQIPERI, banues në Durres, Lagjja nr. 4, Rruga: Hafiz Podgorica, P.157, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. personal I21121050R.

#### NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje gjykatës kompetente.

*Ky Akt-Themelimi përpilohet në 4 (katër) origjinale në gjuhën shqipe.*

#### **ORTAKËT THEMELUES**

*Z. Romir Rexha*



DURRES 06/04/2021

*Z. Dardan Seferaj*

